

Rregullore e regjistrimit të studentëve

e

Akademisë “Evolucion”

Prishtinë

2018

Në bazë të Statutit të Akademisë "Evolucion" (në tekstin e mëtejshëm: "AE"), Bordi i Drejtorëve (në tekstin e mëtejshëm "BiD") i Akademisë "Evolucion" në seancën e mbajtur në Prishtinë më 20.12.2018 miraton këtë:

RREGULLORE E REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE E AKADEMISË "EVOLUCION"

Konkursi publik për regjistrimin e studentëve

Neni 1

Konkursi publik për regjistrimin në programet e studimeve shpallet nga Akademia, në përputhje me Ligjin, Statutin dhe këtë Rregullore.

Përmbajtja e konkursit publik për regjistrimin e studentëve

Neni 2

Konkursi publik për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve në Akademi përmban informacionin si vijon:

- a. numrin e kandidatëve;
- b. koston e studimeve për studentët;
- c. kriteret për renditjen e kandidatëve për regjistrim;
- d. kriteret për vlerësimin e rezultateve të arsimit paraprak;
- e. metodat e vlerësimit të njohurive dhe shkathtësive të kandidatëve (provimet pranuese) që aplikojnë për programin përkatës të studimit;
- f. kohën e caktuar për vlerësimin e aftësive të kandidatëve për programin përkatës të studimit dhe afatin e shpalljes së rezultateve të testimit;

- g. këshilla mbi procedurën e ankesës eventuale dhe procedurën për mbrojtjen e të drejtave të kandidatëve të pakënaqur me rezultatet e provimit pranues;
- h. afatin, në të cilën Akademia duhet të bëjë publike listën përfundimtare të kandidatëve të pranuar;
- i. afatet për regjistrimin e kandidatëve të pranuar.

Informacioni rreth konkursit publik për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve shpallet nga Akademia dhe publikohet në së paku një gazetë ditore të Republikës së Kosovës.

Lista përfundimtare e kandidatëve

Neni 3

- 1) Me rastin e aplikimit në konkursin publik, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet origjinale në përputhje me kushtet e konkursit.
- 2) Pasi të jetë verifikuar nga një organ kompetent, lista e renditjes paraprake e të gjithë kandidatëve të pranuar dhe të regjistruar do të vendoset në tabelën e njoftimeve të Akademisë.
- 3) Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në listën e renditjes së përmendur në pikën 2 të këtij neni, brenda tri ditëve nga shpallja i saj në tabelën e njoftimeve.
- 4) Organi kompetent i Departamentit të Akademisë është i obliguar të marrë një vendim, brenda tri ditëve në ankesën e përmendur në pikën 3 të këtij neni.
- 5) Akademia duhet të shpallë listën përfundimtare të të gjithë studentëve të regjistruar sipas kritereve të departamenteve përkatëse, dy ditë pas skadimit të afatit të marrjes së vendimit në ankesa.

E drejta për t'u regjistruar në ciklin e studimeve Bachelor dhe Master

Neni 4

- 1) Studentët kanë të drejtë të regjistrohen në programet studimore në ciklet e studimeve Bachelor dhe Master sipas kritereve të konkursit.

2) Për regjistrimin në programe të veçanta studimi, Akademia mund të përcaktojë kërkesa shtesë në përputhje me Ligjin, Statutin dhe këtë Rregullore.

E drejta e shtetasve të huaj për t'u regjistruar

Neni 5

Shtetasit e huaj kanë të drejtë të regjistrohen në programet e studimit në Akademi në të njëjtat kushte si shtetasit e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin dhe Statutin e Akademisë.

E drejta për të marrë pjesë në konkurrimin publik para njohjes së kualifikimeve të huaja

Neni 6

1) Kandidatët që kanë përfunduar shkollimin e mesëm / studimet e nivelit Bachelor jashtë Republikës së Kosovës kanë të drejtë të marrin pjesë në konkursin publik për t'u regjistruar në studimet e nivelit Bachelor / Master para se t'u njihet diploma e nivelit të shkollës së mesme / Bachelor.

2) Kandidatët e përmendur në pikën 1 të këtij neni, të cilët plotësojnë kriteret e konkursit publik dhe janë në listën e ngushtë për regjistrim si kandidatët që kanë kaluar provimin e pranimit brenda kuotës së miratuar të studentëve për t'u regjistruar në Akademi, mund të regjistrohen në vitin e parë të studimeve nivelit Bachelor pas njohjes së kualifikimeve të shkollave të mesme, jo më vonë se në fillim të vitit studimor.

3) Në rrethana të jashtëzakonshme, kandidatët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund të regjistrohen me kusht në vitin e parë të studimit edhe para se të njihen kualifikimet e shkollimit paraprak, me paraqitjen e dokumentit që vërteton se ata kanë aplikuar për procedurën e njohjes dhe nuk janë përgjegjës për çdo vonesë në marrjen e vendimit përkatës.

5) Procedura e vërtetimit ose njohjes së certifikatave të arsimit të huaj, diplomave dhe dokumenteve të tjera publike që vërtetojnë përfundimin ose fillimin e shkollimit, kryhet në përputhje me një ligj të veçantë ose në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe të detyrueshme për Republikën e Kosovës.

Kontratat e studimit

Neni 7

Akademia si institucion dhe studenti lidhin një kontratë studimi që specifikon të drejtat dhe detyrimet e tyre reciproke, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20.12.2018.

Kryesues i BiD

Besnik Shatri